



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2023

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: “**BLERIMI**” sh.p.k me adresë: Elbasan, Shirgjan Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rruga Elbasan - Cerrik km 4, pranë lumit Shkumbin.

Procedura e prokurimit: “**Procedurë e hapur**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-83656-10-13-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Investime në fushat sportive (Impjanti i vaditjes dhe drenazhit, në fushën e kompleksit "Shefqet Lamçja dhe rikonstruksioni i terreneve sportive të shkollës së bashkuar Shushicë")**" me fond limit: **23,605,407** (njëzet e tremilion e gjashtëqind e pesë mijë e katërqind e shtatë) **lekë (pa tvsh)**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan, dhe me afat për kryerjen e punimeve **3 muaj nga data e lidhjes së kontratës**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “2Z Kontruksion” sh.p.k me Nipt: J63229466K & "ASI-2A CO" sh.p.k me Nipt: K53002402C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **17,229,026.62** (shtatëmbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e njëzet e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e dy lekë (pa tvsh).

2. “BAJRAMI N.” sh.p.k me Nipt: K027272020

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **19,709,138.4** (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë katër) lekë (pa tvsh).

3. “BLERIMI” sh.p.k me Nipt: J62903384G

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **23,000,000** (njëzet e tremilion) lekë (pa tvsh).

4. “ERGI” sh.p.k me Nipt: K02727229P

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **23,334,013** (njëzet e tremilion e treqind e tridhjetë e katërmijë e trembëdhjetë) lekë (pa tvsh).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “ERGI” sh.p.k me Nipt: K02727229P përkatësisht për arsyet e mëposhtëme:

1. Nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2022 duke mos permbushur kërkesën e parashikuar në piken 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, të kriterëve të veçanta për kualifikim, ku kërkohej:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2. Në përmbushjet të kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta për kualifikim, ka paraqitur kontratat me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Jorgji Dilo" dhe "Rikonstruksion i shesheve të pallateve 650, 651, 652, 653 në lagjen Partizani, Bashkia Elbasan". Pasi u verifikuan situacionet përfundimtare të këtyre objekteve u konstatua se vetëm pak punime janë të ngjashme me objektin e prokurimit të cilat nuk përmbushin vlerën e kërkuar në piken 2.3.1. Theksojme se peshën kryesore në punimet e objektit që prokurohet e

zene ato te drenazhimit dhe sistemimit te fushave te futbollit. Ne kontratat e paraqitura nga subjekti nuk ka punime te kesaj natyre.

3. Nuk ka deklaruar ne shtojcen 8 të vetëdeklarimit/nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe te vertetoje se ka të punësuar punonjës të kualifikuar: **3 shoferë, duke mos permbushur kerkesen e parashikuar ne piken 2.3.6 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim **ku nder te tjera kerkohet:****

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:

- 3 (tre) punonjes shofere

4. Nuk ka deklaruar ne shtojcen 8 të vetëdeklarimit/nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe te vertetoje se disponon mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës: **I tranxhe për perpunimin e hekurit, duke mos permbushur kerkesen e parashikuar ne piken 2.3.10 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim.**

Oferta e “ERGI” sh.p.k me Nipt: K02727229P s’kualifikohet per arsyet e mesiperme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose entë kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

2. BOE “2Z Kontruksion” sh.p.k me Nipt: J63229466K & "ASI-2A CO" sh.p.k me Nipt: K53002402C përkatësisht për arsyet e mëposhtëme:

1. Subjekti "2 Z Konstruksion" sh.p.k. ka marrë përsipër që të kryejë 50 % të punimeve sipas kontrates se bashkepunimit.

Në pikat 2 dhe 3 të nenit 88 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Sa më sipër, duke qene se subjekti "2 Z Konstruksion" sh.p.k. sipas kontrates se bashkepunimit ka marre persiper te realizoje nder te tjera dhe: Punime per drenazhimin dhe sistemin e vaditjes; Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka; Cilindrim me rul; punime shtrese beton/arme; Shtrese zhavori lumi t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese stabilizanti t=5cm; Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur makineri; Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 5cm, me makineri; Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km; F.V. tapete rezine sintetike me ngjyra per terrene sportive (Mapecoat TNS Finish); FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE; atehere ne kuptim te parashikimeve ligjore te sipercituara dhe në përmbushje te kerkesave profesionale dhe teknike per kualifikim te parashikuara ne piken 2.3.6, 2.3.10 dhe 2.3.12 te kapacitetit teknik, duhet te kishte deklaruar ne shtojcen 8 të vetëdeklarimit apo te kishte paraqitur dokumentacion minimalisht per:

a. Mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Grejder	copë 1
Helikopter per siperfaqe betoni	copë 1
Rrul hekur–hekur me kapacitet 4 ton - 7 ton	copë 1
Rrul hekur –hekur me kapacitet mbi 10 ton	copë 1
Rrul hekur –gome me kapacitet mbi 18 ton	copë 1

Subjekti "2 Z Konstruksion" sh.p.k. ka deklaruar ne shtojcen 8 të vetëdeklarimit se disponon tre rula, por pa specifikuar tonazhin e tyre duke mos qene ne perputhje me kerkesat e parashikuara ne piken 2.3.10. Eshte pergjegjesi e OE te paraqesin dokumentacionin e kerkuar apo te deklarojne ne menyre te sakte disponimin e mjeteve ashtu sic kerkohet ne dokumentat e tenderit.

b. Punonjes të kualifikuar:

1 (nje) punonjes topograf

1 (nje) punonjes pllakashtrues

2 (dy) punonjes shofere

Per shoferet ka paraqitur nje deklarate qe ato jane punesuar per mjetet me qira dhe nuk figurojne ne listepagesat e paraqitura nga ana juaj per tre muajt e fundit.

Mosfigurimi ne listepagesa per mjetet me qera eshte kerkuar vetem per manovratoret e mjeteve te renda.

c. Kontrate furnizimi per produktin "tapete rezine sintetike" dhe tuba ujesjellesi PE.

Per tubat e ujesjellesit PE ka deklaruar dhe paraqitur autorizim dhe jo kontrate furnizimi sic kerkohet ne piken 2.3.12 apo edhe sic e kerkon formati i shtojces se vetedeklarimit.

ASI - 2A CO

2. Subjekti "ASI - 2A CO" sh.p.k. ka marrë përsipër që të kryejë 50 % të punimeve sipas kontrates se bashkepunimit.

1. Në pikat 2 dhe 3 të nenit 88 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. **Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.**

Duke qene se OE kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, ne marreveshjen e bashkepunimit te paraqitur nuk eshte percaktuar se kush nga OE anetar i bashkimit do te plotesoje kushtin e përcaktuar në shkronjën “a”, cka bie ne kundërshtim me parashikimet ligjore te lartepemendura.

Në përmbushje te kriterit 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim, subjekti "ASI - 2A CO" sh.p.k. paraqitur kontratat me objekt: "Mirembajtje e thelle ne

terrenet e jashtme sportive", "Rikualifikim i kendit te forces 1 dhe hapësire rekreative" dhe "Objekt thertore 1 kat".

Kontrata "Objekt thertore 1 kat" lidhur midis subjektit "ASI - 2A CO" sh.p.k. dhe investitorit "Nikos Semanjakos" p.f. nuk eshte e ngjashme me kontraten qe prokurohet ku punimet jane te nje natyre tjeter e konkretisht **impjanti i vaditjes dhe drenazhit, në fushën e kompleksit "Shefqet Lamçja dhe rikonstruksioni i terreneve sportive të shkollës së bashkuar Shushice.**

Sa mesiper, kjo kontrate nuk do te merret ne konsiderate.

Ne kontraten me objekt "Mirembajtje e thelle ne terrenet e jashtme sportive" subjekti "ASI - 2A CO" sh.p.k. ka marre persiper te kryejë 50.47 % te punimeve e shprehur ne vlere absolute prej 4,536,525 leke pa tvsh.

Ne kontraten me objekt "Rikualifikim i kendit te forces 1 dhe hapësire rekreative" subjekti "ASI - 2A CO" sh.p.k. ka marre persiper te kryejë 27.29 % te punimeve e shprehur ne vlere absolute prej 5,842,580 leke pa tvsh.

Duke gene se nuk eshte percaktuar se kush do ta plotesoje kushtin e shkronjes "a", AK vleresoi te dy OE anetare te bashkimit sipas kushtit shkronjes "a", nga ku rezulton se asnjera nga 2 kontatat e paraqitura nga subjekti "ASI - 2A CO" sh.p.k. nuk e permush kete kusht pasi vlere qe duhet te permbushet per nje objekt te vetem eshte 11,802,704 leke.

Por edhe sikur ti vleresonim keto dy kontrata ne raport me perqindjen e e pjesëmarrjes në bashkim perseri kushti i parashikuar ne shkronjen "a" nuk permbushet e konkretisht:

Duke gene se subjekti "ASI - 2A CO" sh.p.k ka marre persiper te kryejë 50 % te punimeve vlere qe duhet te permbushet per nje objekt te vetem eshte 50 % e 50 % te fondit limit e llogaritur ne vlere absolute : 50 % e FL = 50 % e 23,605,407 = 11,802,704. Vlere qe duhet per nje objekt te vetem: 50 % e 11,802,704 = 5,901,352. Kjo vlere eshte me e madhe se vlerat e kontratave te mesiperme duke mos permbushur keshtu kushtin e percaktuar ne shkronjen "a" te pikes 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim.

Gjithashtu totali i vlerave per dy kontrata e mesiperme nuk permbush as vleren e percaktuar ne kushtin e shkronjes "b".

2. Në pikat 2 dhe 3 të nenit 88 të VKM 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet se:

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Sa më sipër, duke qene se subjekti "ASI - 2A CO" sh.p.k sipas kontrates se bashkepunimit ka marre persiper te realizoje nder te tjera dhe: Punime per drenazhimin dhe sistemin e vaditjes; Rrethimi i fushes minifutbollit me rrjete teli te plastifikuar jeshile (H=3m); atehere ne kuptim te parashikimeve ligjore te sipercituara dhe në përmbushje te kerkesave profesionale dhe teknike per kualifikim te parashikuara ne pikën 2.3.5 dhe 2.3.12 te kapacitetit teknik, duhet te kishte deklaruar ne shtojcen 8 të vetëdeklarimit apo te kishte paraqitur dokumentacion minimalisht per:

a. 1 inxhinier gjeodet

b. Kontrate furnizimi per produktin "rrjete teli e plastifikuar".

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punimeve të marra përsipër. Ky eshte edhe qendrimi i mbajtur ne vazhdimesi nga KPP (shiko vendimin nr.160/2020)

Oferta e BOE “2Z Kontruksion” sh.p.k me Nipt: J63229466K & "ASI-2A CO" sh.p.k me Nipt: K53002402C s’kualifikohet per arsyet e mesiperme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

3. “BAJRAMI” sh.p.k me Nipt: K02727202O përkatësisht për arsyet e mëposhtëme:

Operatori ekonomik “BAJRAMI” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacionin në afatin e kërkuar siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Oferta e operatorit “BAJRAMI” sh.p.k me Nipt: K027272020 s’kualifikohet per arsyen e mësipërme.

Në nenin 76 pika 3 gërma ë) e Ligjit nr.162 date 23.12.2020 ndër të tjera thuhet se autoriteti kontraktor skualifikon çdo operator, i cili nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“BLERIMI” sh.p.k** me adresë: Elbasan, Shirgjan Mjebes, Fshati Mjebes, Zona Topcias, Rruga Elbasan - Cerrik km 4, prane lumit Shkumbin, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **23,000,000** (njëzet e tremilion) **lekë (pa tvsh)**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari
Aulona Bylykbashi**